



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut
Vendimi nr. 01\03
10 dhjetor 2021, Junik

Bazuar në nenin 58 paragrafin g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 42 paragrafin i) nenin 43 të Statutit të Komunës së Junikut nr. 001/3/27 të datës 30.09.2010, dhe Rregullores për përdorimin e Automjeteve Zyrtare 2-4-2534 të datës 17.04.2012 Kryetari i Komunës së Junik merr:

VENDIM

- I. Ndalohet përdorimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut jashtë orarit zyrtar të punës përveç për arsye dhe nevoja zyrtare të Komunës së Junikut.
- II. Ndalohet përdorimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut për shërbime private të zyrtarëve të Komunës së Junikut ose për arsye dhe nevoja të tjera jo zyrtare.
- III. Ndalohet përdorimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut në të gjitha rastet kur është në kundërshtim me aktet juridike në fuqi për përdorimin e automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut.
- IV. Lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut vetëm në përputhje me normat juridike në fuqi për përdorimin e automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut.
- V. Ndaj të gjithë zyrtarëve të Komunës së Junikut që veprojnë në kundërshtim me normat juridike në fuqi lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare të Komunës së Junikut, do të veprohet në përputhje me rregullat përkatëse për përgjegjësinë disiplinore të zyrtarëve në Komunën e Junikut.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Drejtorit të Administratës në Komunën e Junikut
2. Arkivit të Komunës së Junikut

Kryetari i Komunës së Junikut


Ruzhdi SHEHU
1
JUNIK